



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatës Kai Ambos

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 1 tetor 2021

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

**Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit ndaj Vendimit mbi Rishikimin e
Paraburgimit**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave:
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit:
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:
Venkatesvari Alagenda

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹ duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”) ka marrë në shqyrtim një apel të dorëzuar për protokollim më 7 korrik 2021 nga z. Jakup Krasniqi (“Krasniqi” ose “i akuzuari”),² kundër “Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit” (“Vendimi i Kontestuar”).³ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) u përgjigj më 19 korrik 2021 se Apeli duhej rrëzuar.⁴ Krasniqi u kundërpërgjigj më 26 korrik 2021.⁵

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 nëntor 2020, Krasniqi u arrestua në bazë të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁶ pas konfirmimit të Aktakuzës kundër tij.⁷

¹ F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 8 korrik 2021 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 30 shtator 2021).

² F00001, Apel i Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit, 7 korrik 2021 (konfidencial) (“Apeli”).

³ F00371/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Jakup Krasniqit, 30 qershor 2021 (origjinali u protokollua më 25 qershor 2021) (“Vendimi i Kontestuar”).

⁴ F00003/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Përgjigjes ndaj Apelit të Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Paraburgimin të qershorit 2021, 19 korrik 2021 (origjinali u protokollua më 19 korrik 2021) (“Përgjigja”), para. 2, 30.

⁵ F00004, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Apelit të Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Paraburgimin të qershorit 2021, 26 korrik 2021 (konfidenciale) (“Kundërpërgjigja”).

⁶ F00027/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 26 nëntor 2020 (origjinali u protokollua më 26 tetor 2020); F00027/A07/COR/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Jakup Krasniqin, 11 nëntor 2020 (origjinali u protokollua më 26 tetor 2020, versioni i korrigjuar u protokollua më 28 tetor 2020); F00044, Njoftim për Arrestimin e Jakup Krasniqit në pajtim me rregullën 55(4), 4 nëntor 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 20 nëntor 2020), para. 4.

⁷ F00026/RED, Versioni Publik i Redaktuar i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 30 nëntor 2020 (origjinali u protokollua më 26 tetor 2020). Aktakuza në fuqi u protokollua më 4 nëntor 2020; F00045/A03, Aktakuzë e redaktuar më tej, 4 nëntor 2020 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si publike më 5 nëntor 2020).

2. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën e tij për lirim të përkohshëm.⁸
3. Më 30 prill 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit e rrëzoi apelin e Krasniqit kundër Vendimit të Parë për Paraburgimin.⁹
4. Më 25 qershor 2021, pasi mori parashtrimet e Krasniqit dhe të ZPS-së,¹⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Kontestuar dhe urdhëroi mbajtjen në paraburgim të Krasniqit, pasi konstatoi se ekzistojnë ende rreziqet që Krasniqi do të arratiset, do të pengojë punën e Dhomave të Specializuara ose do të kryejë krime të tjera kundër atyre që perceptohen se janë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), përfshirë dëshmitarë të mundshëm.¹¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi më tej se kushtet e propozuara nga Krasniqi në lidhje me Vendimin e Parë për Paraburgimin për lirimin e tij me kushte (“Kushtet e Propozuara”) mund ta zvogëlonin rrezikun e arratisjes, por se Kushtet e Propozuara, apo çdo masë shtesë, nuk do t’i zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e pengimit të ecurisë së procedurave të Dhomave të Specializuara apo rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera.¹² Së fundi, ai konstatonte se paraburgimi i Krasniqit vijonte të ishte proporcional.¹³

⁸ F00122/RED, Version i Redaktuar Publik i Kërkesës për Lirim të Përkohshëm, 18 dhjetor 2020 (originali u protokollua më 7 dhjetor 2020; F00180/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Jakup Krasniqit për Lirim të Përkohshëm, 26 janar 2021 (origjinali u protokollua më 22 janar 2021), para. 52 (“Vendimi i Parë mbi Paraburgimin”).

⁹ F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit mbi Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (origjinali u protokollua më 30 prill 2021) (“Vendimi mbi Apelin e Krasniqit”), para. 84.

¹⁰ Shih F00329/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Mbrojtjes së Krasniqit mbi Rishikimin e Paraburgimit, KSC-BC-2020-06/F00329, datë 31 maj 2021, 30 qershor 2021 (origjinali u protokollua më 31 maj 2021) (“Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit”); F00345/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Krasniqit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 14 qershor 2021 (origjinali u protokollua më 10 qershor 2021) (“Përgjigja mbi Rishikimin e Paraburgimit”); F00358/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes mbi Rishikimin e Paraburgimit, KSC-BC-2020-06/F00358, datë 18 qershor 2021, 30 qershor 2021 (origjinali u protokollua më 18 qershor 2021) (“Kundërpërgjigja ndaj Parashtrimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit”).

¹¹ Vendimi i Kontestuar, para. 30, 40, 44-45, 61.

¹² Vendimi i Kontestuar, para. 49, 53.

¹³ Vendimi i Kontestuar, para. 59.

5. Në Apel, Krasniqi shtjellon katër arsye të apelit ku argumenton se Vendimi i Kontestuar përmban një sërë gabimesh ligjore dhe faktike të cilat, veçmas ose bashkërisht, kanë çuar në konstatimin e gabuar se është i domosdoshëm vijimi i mbajtjes së tij në paraburgim.¹⁴ Për rrjedhojë, Krasniqi i kërkon Panelit të Gjykatës së Apelit t'i ndreqë këto gabime, të zbatojë standardet e sakta juridike për provat dhe t'ia miratojë lirimin e përkohshëm.¹⁵

II. STANDARDI I SHQYRTIMIT

6. Paneli i Gjykatës së Apelit përdor standardin e shqyrtimit për apelimet e ndërmjetme të vendosur në vendimin e tij të parë dhe të zbatuar në vijimësi.¹⁶

III. DISKUTIM

A. PARASHTRIMET E PROTOKOLLUARA PUBLIKE

7. Paneli vëren se Krasniqi ende nuk ka dorëzuar për protokollim versione të redaktuara publike të Apelit dhe Kundërpërgjigjes së tij. Duke pasur parasysh se të gjitha parashtrimet e protokolluara në Dhomat e Specializuara duhet të jenë publike me përjashtim kur ka arsye të jashtëzakonshme për t'i mbajtur konfidenciale dhe se Palët duhet të protokollojnë versione të redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve të bëra para Panelit,¹⁷ Paneli urdhëron Krasniqin të protokollojë versionet e redaktuara publike të Apelit të tij dhe të Kundërpërgjigjes së tij, ose të bëjë të ditur, përmes një

¹⁴ Apeli, para. 4-5.

¹⁵ Apeli, para. 5, 54.

¹⁶ KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të Lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, para. 4-14. Shih edhe, p.sh., KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021 ("Vendimi mbi Apelin e Haradinajt"), para. 11-14; Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 4-7.

¹⁷ Shih, p.sh., KSC-BC-2020-07, F00007, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit për Mocionet Paraprake, 23 qershor 2021 ("Vendim mbi Apelet e Gucatit dhe Haradinajt mbi Mocionet Paraprake"), para. 13; F00005/RED, Version Publik i Redaktuar i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 ("Vendimi mbi Apelin e Thaçit"), para. 10.

parashtrimi të protokolluar, nëse këto ato mund të riklasifikohen publike brenda dhjetë ditëve pas marrjes njoftim të këtij Vendimi.

8. Gjithashtu, Paneli i Gjykatës së Apelit vëren se detyrimi që parashtrimet e protokolluara të jenë publike **sa më shumë që të jetë e mundshme nënkupton automatikisht** që parashtrimet e protokolluara duhet të bëhen publike (për shembull, me anë të redaktimit) sapo të jetë e mundur. Kjo, jo vetëm që është në respektim të parimit të procedurave publike, por ka edhe avantazhe praktike, duke e ndihmuar Panelin të vlerësojë, për shembull, se cilat informacione brenda një parashtrimi të protokolluar konfidencial duhen redaktuar nga vendimi i tij dhe cilat mund të bëhen publike. Për rrjedhojë, Paneli u rikujton Palëve të dorëzojnë sa më shpejt versione të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre të protokolluara dhe të mos presin që për këtë t'u japë urdhër Paneli.

B. GABIMI I PRETENDUAR LIDHUR ME STANDARDIN E ZBATUESHËM PËR RISHIKIMIN E PARABURGIMIT DHE OPINIONI I ARSYETUAR

1. Parashtrimet e Palëve

9. Krasniqi argumenton se Vendimi i Kontestuar në përgjithësi nuk jep arsye adekuate, pavarësisht nga konstatimet që ka bërë në të shkuarën Paneli i Gjykatës së Apelit.¹⁸

10. ZPS-ja përgjigjet se, në mungesë të një justifikimi për rivlerësim, nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kërkohet të bënte arsyetim të mëtejshëm të faktorëve që janë lënë tashmë në fuqi nga Paneli i Gjykatës së Apelit, pavarësisht se Paneli kishte konstatuar mangësi në arsyetimin e tij dhe kishte kryer analizën e vet mbi aspekte të ndryshme.¹⁹ ZPS-ja mbështetet në veçanti në pikën ku Paneli është shprehur se

¹⁸ Apeli, para. 15, ku citohet Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 32; Kundërpërgjigjja, para. 2. Krasniqi jep dy shembuj të mungesës së arsyetimit (shih Apeli, para. 15, ku citohet Vendimi i Kontestuar, para. 39, 60, poshtëshënimi 97), dhe bëhet referim në paragrafë të tjerë të Apelit për shembuj të tjerë (shih Apeli, poshtëshënimi 27). Shih edhe Apeli, para. 54.

¹⁹ Përgjigjja, para. 8-11.

konstatimet faktike mbi të cilat mbështetet paraburgimi nuk ka nevojë të bëhen sërish në vendimet e mëpasshme.²⁰ ZPS-ja argumenton më tej se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë arsyetim të plotë në përgjigje të parashtrimeve të reja të Krasniqit.²¹

2. Analiza e Panelit të Gjykatës së Apelit

11. Paneli i Gjykatës së Apelit rikujton dispozitat e Ligjit dhe të Rregullores që kanë lidhje me rishikimin e paraburgimit.

12. Neni 41(10) i Ligjit parashikon se:

Deri në kohën kur aktgjykimi të merr formën e prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas aktvendimit të fundit për paraburgim, gjyqtari i procedurës paraprake ose trupi gjykues i informuar për rastin shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerrin aktvendim për lirimin apo ndërprerjen e paraburgimit. Palët mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktvendimi në Panelin e Gjykatës së Apelit.

13. Rregulla 57(2) e Rregullores thotë:

Pas caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit, dhe deri kur aktgjykimi të marrë formë të prerë, paneli i angazhuar me çështjen vlerëson vendimin mbi mbajtjen në paraburgim, pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, në përputhje me nenin 41(10), (11) dhe (12) të Ligjit, ose në çdo kohë me kërkesë të të akuzuarit ose Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*, nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave.

14. Në Vendimin mbi Apelin e *Haradinajt*, të cilin Paneli i Gjykatës së Apelit e mori në lidhje me apelin e *Haradinajt* ndaj vendimit të parë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi rishikimin e paraburgimit të *Haradinajt*, Paneli konstatoi se:

Paneli kompetent ka detyrimin të shqyrtojë arsyet ose rrethanat mbi të cilat mbështetet paraburgimi dhe të konstatojë nëse këto arsye vijnë në ekzistencë në bazë të nenit 41(6) të Ligjit. Panelit kompetent nuk i kërkohet të bëjë konstatime mbi faktorë për të cilët është marrë vendim më parë në vendimin fillestar por duhet t'i shqyrtojë këto

²⁰ Përgjigja, para. 10, ku citohet ndër të tjera Vendimi mbi Apelin e *Haradinajt*, para. 55.

²¹ Përgjigja, para. 10.

arsye dhe rrethana dhe të vendosë nëse ekzistojnë ende. Ajo që ka rëndësi thelbësore është që paneli kompetent të bindet se, në momentin e vendimit të rishikimit, ka ende arsye për vijimin e mbajtjes në paraburgim.²²

15. Paneli mendon se është i nevojshëm një shpjegim i mëtejshëm i mënyrës si duhen interpretuar konstatimet. Në këtë aspekt, Paneli nënvizon se detyrimi për të konstatuar nëse “ekzistojnë ende” rrethanat që kërkojnë mbajtjen në paraburgim²³ nuk është i lehtë. Ky detyrim i ngarkon panelit kompetent detyrën që të vlerësojë, *proprio motu*, nëse në momentin e rishikimit dhe në rrethanat konkrete të rastit në kohën kur bëhet rishikimi, ai është ende i bindur se vijon të jetë e nevojshme mbajtja në paraburgim e të akuzuarit.

16. Paneli mban parasysh se, sipas Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, fraza “ndryshim të rrethanave” në rregullën 57(2) të Rregullores zbatohet për rishikimin e paraburgimit në çfarëdo kohe dhe veçmas nga rishikimi çdo dy muaj që kërkon ligji. Një rishikim i tillë “garanton vlerësimin e faktorëve të rinj të rëndësishëm që mund të paraqiten në periudhën midis dy rivlerësimeve të paraburgimit”.²⁴ Paneli konstaton se, megjithëse rishikimi që bëhet automatikisht çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk ka të bëjë vetëm me faktin nëse kanë ndryshuar ose jo rrethanat e rastit, një ndryshim i tillë gjithsesi mund të jetë përcaktues dhe duhet marrë në konsideratë nëse ngrihet përpara panelit ose *proprio motu*.²⁵

17. Për sa më lart, Paneli është bindur se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka zbatuar standardin e saktë.²⁶ Gjithashtu, Paneli konstaton se nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të pritët që të marrë në konsideratë parashtrime të

²² Vendimi mbi Apelin e Haradinajt, para. 55.

²³ Shih nenin 41(10) të Ligjit: “nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim”.

²⁴ KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Aktvendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 26 maj 2020, para. 67.

²⁵ Rregulla 57(2) e Rregullores.

²⁶ Shih Vendimi i Kontestuar, para. 19.

cilat vetëm sa përsëritin argumente që tashmë janë trajtuar në vendimet e tij të mëparshme.²⁷

18. Sa i takon argumenteve të Krasniqit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake në mënyrë të përsëritur nuk ka dhënë arsye të plota ose nuk ka dhënë asnjë arsye për konstatime me rëndësi kritike në Vendimin e Kontestuar,²⁸ Paneli do t'i trajtojë drejtpërdrejt këto pretendime në pjesët përkatëse të diskutimit më poshtë, vetëm për konstatimet e kundërshtuara të cilat janë identifikuar konkretisht.²⁹ Paneli e hedh poshtë menjëherë si të pashtjelluar dhe të pabazuar pretendimin e përgjithshëm të Krasniqit për mosdhënie "në përgjithësi" të një mendimi të arsyetuar.³⁰

C. GABIMET E PRETENDUARA LIDHUR ME VLERËSIMIN E NENIT 41(6)(B) TË LIGJIT (ARSYET 1-2)

1. Neni 41(6)(b)(ii) i Ligjit

(a) Parashtrimet e Palëve

19. Së pari, Krasniqi argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar që u mbështet në [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].³¹ Ai argumenton se [REDAKTUAR], sepse inventari i mbajtur në momentin e kontrollit [REDAKTUAR] është i paqartë dhe [REDAKTUAR] një inventar pas më shumë se [REDAKTUAR]. Sipas mendimit të tij, është shkelur procedura e rregullës 39(4) të Rregullores dhe ka dyshime thelbësore

²⁷ Shih, p.sh., ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-1626-Red, Public Redacted Version of Judgment on the appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo against the decision of Trial Chamber III of 27 June 2011 entitled "Decision on Applications for Provisional Release", 12 shtator 2011, para. 60; ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-1019, Judgment on the appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo against the decision of Trial Chamber III of 28 July 2010 entitled "Decision on the review of the detention of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo pursuant to Rule 118(2) of the Rules of Procedure and Evidence", 19 nëntor 2010, para. 53.

²⁸ Apeli, para. 15.

²⁹ Po aty.

³⁰ Shih, p.sh., Vendimi mbi Apelin e Haradinajt, para. 29 dhe jurisprudencën e cituar në të.

³¹ Apeli, para. 17-25.

për besueshmërinë e saj, çka e bën [REDAKTUAR] të papranueshme sipas rregullës 138(2) të Rregullores.³²

20. Si alternativë dhe gjithsesi, Krasniqi mban qëndrimin se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar në mënyrë të paarsyeshme se [REDAKTUAR] përforcon [REDAKTUAR]³³ dhe nuk ka dhënë shpjegim për konstatimin e tij të paarsyeshëm se [REDAKTUAR].³⁴

21. Së dyti, Krasniqi argumenton se konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ai ka pozitë me ndikim që i jep mundësi të marrë mbështetjen e simpatizantëve, ishte i paarsyeshëm dhe i hamendshëm.³⁵ Ai parashtron se nuk ka prova që ai është përpjekur të marrë një mbështetje të tillë dhe se Vendimi i Kontestuar nuk i identifikon simpatizantët e pretenduar, kapacitetet apo burimet e tyre.³⁶

22. Së treti, Krasniqi argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka shpjeguar përse rreziku i frikësimit apo ndërhyrjes “është vetvetiu i lartë” ose përse ai “nuk është bindur” se mund të “zvogëlohet në mënyrë efikase duke u mbështetur vetëm në masat mbrojtëse”.³⁷ Sipas Krasniqit, kjo ia ndërron kahun barrës së provës dhe nuk e lidh rrezikun me vetë Krasniqin.³⁸ Ai pretendon se rreziku i ndërhyrjes është eliminuar ose është “zvogëluar në mënyrë drastike” nga sasia dhe natyra “veçanërisht e skajshme” e masave mbrojtëse në këtë çështje. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej të merrte në konsideratë këtë faktor dhe nuk ka shpjeguar pse ishte i pamjaftueshëm për ta zvogëluar rrezikun e pengimit të procedurave.³⁹

³² Apeli, para. 18, 21; Kundërpërgjigja, para. 3-4.

³³ Apeli, para. 24.

³⁴ Apeli, para. 24-25.

³⁵ Apeli, para. 26, ku citohet Vendimi i Kontestuar, para. 38.

³⁶ Apeli, para. 26, ku citohet Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 55.

³⁷ Apeli, para. 27, ku citohet Vendimi i Kontestuar, para. 39; Kundërpërgjigja, para. 7-10. Shih edhe Apeli, para. 15.

³⁸ Apeli, para. 28, 31; Kundërpërgjigja, para. 8, 10.

³⁹ Apeli, para. 29-31; Kundërpërgjigja, para. 9-10.

23. ZPS-ja përgjigjet se Krasniqi nuk identifikon asnjë gabim të dallueshëm apo justifikim për rivlerësimin e faktorëve që lidhen me pozitën me ndikim të tij, [REDAKTUAR] dhe atmosferën e frikësimit.⁴⁰ ZPS-ja parashtron se nuk është shkelur rregulla 39(4) e Rregullores sepse Krasniqi ka marrë një inventar të mbajtur në atë kohë, [REDAKTUAR] edhe një inventar zyrtar më datë 28 prill 2021, [REDAKTUAR].⁴¹ ZPS-ja parashtron se “pranueshmëria” e provave ka të bëjë vetëm me vlerësimin e tyre në gjykim dhe është e parakohshme të vendoset lidhur me pranueshmërinë [REDAKTUAR].⁴² Megjithatë, ajo argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka shpjeguar me hollësi përse [REDAKTUAR].⁴³

24. Së fundi, sa u takon masave mbrojtëse, ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka gabuar dhe nuk ishte i detyruar të jepte përsëri arsye për konstatimin se rreziku me të cilin përballen dëshmitarët e ZPS-së në këtë çështje gjyqësore është “vetvetiu i lartë”.⁴⁴ Sipas ZPS-së, përmendja nga Krasniqi e sasisë së masave mbrojtëse, shumë prej të cilave datojnë përpara Vendimit të Parë për Paraburgimin, nuk dëshmon asnjë gabim të dallueshëm nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.⁴⁵

25. Krasniqi kundërpërgjigjet se ZPS-së nuk i duhet lejuar të mbështetet në dokumente të papranueshme të marrë në shkelje të Rregullores.⁴⁶ Ai e kundërshton mbështetjen e ZPS-së te jurisprudenca e Gjykatës Penale Ndërkombëtare e cila, sipas tij, nuk tregon se pranueshmëria e provave nuk është asnjëherë me rëndësi për lirimin e përkohshëm.⁴⁷

⁴⁰ Përgjigjja, para. 15, 19, 21. Shih edhe Përgjigjja, para. 10-11.

⁴¹ Përgjigjja, para. 16-17.

⁴² Përgjigjja, para. 17. ZPS-ja shprehet se nuk është e nevojshme që Dhoma të vlerësojë pranueshmërinë e provave në funksion të një vendimi për lirim ose mbajtje në paraburgim. Përgjigjja, poshtëshënimi 25 dhe jurisprudenca e Gjykatës Penale Ndërkombëtare e cituar aty.

⁴³ Përgjigjja, para. 18.

⁴⁴ Përgjigjja, para. 20.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Kundërpërgjigjja, para. 5.

⁴⁷ Kundërpërgjigjja, para. 6.

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

26. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se vijon të ekzistojë rreziku se Krasniqi do ta pengojë ecurinë e procedurave të Dhomave të Specializuara sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit në bazë të këtyre faktorëve: (i) [REDAKTUAR]; (ii) pozita me ndikim që i jep atij mundësi të marrë mbështetjen e simpatizantëve; dhe (iii) klima e vazhdueshme e frikësimit dhe ndërhyrjes në procedurat penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së.⁴⁸

27. Paneli së pari trajton ndikimin e Krasniqit. Paneli vëren se, në Vendimin e Kontestuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se zhvillimet në zgjedhjet e fundit në Kosovë nuk e cenonin konstatimin e tij të mëparshëm se, si ish-udhëheqës politik dhe ish-zëvendëskomandant i UÇK-së, Krasniqi ende ka një pozitë me ndikim në Kosovë.⁴⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake është shprehur se kjo pozitë me ndikim i jep mundësi të kërkojë mbështetjen e personave që janë simpatizantë të tij dhe/ose simpatizantë të UÇK-së për të penguar procedurat e Dhomave të Specializuara.⁵⁰ Paneli rikujton që në Vendimin mbi Apelin e Krasniqit, ai konstatoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte gabuar në konstatimin se Krasniqi vijonte të gëzonte një pozitë me ndikim në Kosovë për shkak të funksioneve të tij të mëparshme.⁵¹ Kjo nuk ka ndryshuar. Por, Paneli i Gjykatës së Apelit konstatoi gjithashtu se provat ishin të pamjaftueshme për të demonstruar se mendimet e Krasniqit mund të mobilizojnë rrjete mbështetjeje, përfshirë vartës të tanishëm dhe të mëparshëm, se nuk ka prova konkrete ndikimi të ushtruar nga Krasniqi kundrejt individëve në kuadër të rrjetit mbështetës të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së dhe se nuk ishin parashtruar as prova në lidhje me ekzistencën e një rrjeti mbështetjeje, si për përbërjen, kapacitetin apo burimet e tij.⁵²

⁴⁸ Vendimi i Kontestuar, para. 35-38, 40.

⁴⁹ Vendimi i Kontestuar, para. 36. Shih edhe Vendimi i Kontestuar, para. 38.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 52.

⁵² Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 54-56.

28. Siç ka vërejtur Mbrojtja, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i referohet më mbështetjes së një “rrjeti” mbështetësish por mbështetjes së “simpatizantëve të tij dhe/ose të UÇK-së” ose të “simpatizantëve”.⁵³ Megjithëse Paneli konstaton se është e arsyeshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të konstatojë se Krasniqi vijon të ketë një pozitë me ndikim në Kosovë, Paneli gjithsesi gjen vlerë në parashtrimin e Krasniqit se provat mbi të cilat është mbështetur Gjykatësi i Procedurës Paraprake janë të pamjaftueshme për të dalë në mënyrë të arsyeshme në përfundimin se ai ushtron ndikim mbi simpatizantët e UÇK-së, në mungesë të provave të reja konkrete të parashtruara pas vlerësimit të mëparshëm, që do ta mbështesnin një konstatim të tillë. Në këtë aspekt, Paneli nuk është i bindur se materiali i parashtruar nga ZPS-ja do të mund të mjaftonte për të treguar se si do të ishte faktikisht në gjendje Krasniqi të ushtronte ndikim mbi simpatizantët e UÇK-së për aq sa duket se nuk ka asnjë provë në këtë material që e lidh Krasniqin me ngjarjet e përmendura në të.⁵⁴ Për rrjedhojë, ky konstatim duhet rrëzuar. Paneli do t’i trajtojë në vijim rrjedhojat e këtij konstatimi, nëse ka.

29. Paneli do të trajtojë tani [REDAKTUAR]. Në Vendimin e Kontestuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujtoi konstatimin e bërë më parë prej tij për ekzistencën e rrezikut të pengimit të procedurave, ndër të tjera në [REDAKTUAR].⁵⁵ Për këtë, Paneli ka konstatuar në Vendimin mbi Apelin e Krasniqit se kjo tregonte, më së paku, se Krasniqi ishte i predispozuar për frikësim të dëshmitarëve.⁵⁶ Sa i takon [REDAKTUAR], Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se, [REDAKTUAR].⁵⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi më tej se [REDAKTUAR].⁵⁸ Gjykatësi i

⁵³ Shih Vendimi i Kontestuar, para. 36, 38. Shih Apeli, para. 26.

⁵⁴ Shih Përgjigja mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 7-8, që i referohet Vendimi i Kontestuar, para. 33(ii).

⁵⁵ Vendimi i Kontestuar, para. 35.

⁵⁶ Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 62. Shih edhe Vendimi i Kontestuar, para. 35.

⁵⁷ Vendimi i Kontestuar, para. 37.

⁵⁸ Po aty.

Procedurës Paraprake e rrëzoi edhe kundërshtimin e Krasniqit sa i takon pranueshmërinë [REDAKTUAR].⁵⁹

30. Paneli vëren se në Apelin e tij, Krasniqi nuk kundërshton mbështetjen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në [REDAKTUAR]. Paneli i Gjykatës së Apelit ka konstatuar më parë në lidhje me [REDAKTUAR] se: (i) [REDAKTUAR]; (ii) [REDAKTUAR]; (iii) [REDAKTUAR]; (iv) [REDAKTUAR]; dhe (v) [REDAKTUAR] Krasniqi është i predispozuar për frikësim të dëshmitarëve.⁶⁰ Në mungesë të një ndryshimi të rrethanave të identifikuara që do të cenonte konstatimin e mëparshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Paneli mendon se ky konstatim qëndron edhe sot. Paneli është bindur se ky faktor në vetvete konfirmon [REDAKTUAR] dhe mbështet përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ekziston rreziku se, nëse do të lirohet, Krasniqi do të pengojë ecurinë e procedurave penale.

31. Për pasojë, nuk është e nevojshme që Paneli të trajtojë argumentet e Krasniqit në lidhje me pretendimin për mbështetje të gabuar nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në [REDAKTUAR].⁶¹ Për rrjedhojë, Paneli mendon se nuk është nevojshme në këtë fazë dhe në kuadër të këtij Vendimi, të marrë vendim nëse rregullat mbi pranueshmërinë e provave në gjykim janë domosdoshmërisht të zbatueshme në kontekstin e çështjeve që lidhen me paraburgimin dhe të bëjë vlerësimin e pranueshmërisë së [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] nuk u përdor si bazë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake me qëllim konstatimin e përgjegjësisë së të akuzuarit në gjykim. [REDAKTUAR] u mor në konsideratë vetëm në kuadër të vlerësimit të rrezikut të pengimit të procedurave sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit.

⁵⁹ Vendimi i Kontestuar, para. 16.

⁶⁰ Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 61-62, 65.

32. Po kështu, dhe duke pasur parasysh sa konstatohet më lart se [REDAKTUAR] në vetvete mbështet ekzistencën e rrezikut të pengimit të procedurave,⁶² Paneli konstaton se mbështetja e gabuar e Gjykatësi i Procedurës Paraprake në ndikimin që pretendohet se ushtron Krasniqi mbi persona që simpatizojnë UÇK-në⁶³ nuk e zhvlerëson përfundimin e tij të përgjithshëm se vijon të ekzistojë rreziku se, nëse lirohet, Krasniqi do të pengojë ecurinë e procedurave penale. Për rrjedhojë, Paneli konstaton se Krasniqi nuk ka arritur të demonstrojë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar në këtë konstatim.

33. Së fundi, Paneli do të trajtojë pretendimin se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur nuk konstatoi se natyra ekstensive e masave në këtë çështje gjyqësore ose e ka eliminuar ose e ka zvogëluar në mënyrë drastike çdo rrezik të mbetur të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve. Megjithëse Krasniqi argumenton se nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake “kërkohej” të merrte në konsideratë ndikimin e masave mbrojtëse në rreziqet përkatëse, Paneli konstaton se ai nuk arrin të demonstrojë se ky është një kriter sistematik.⁶⁴ Paneli rikujton se, megjithëse në disa raste dhomat e disa tribunalëve penalë ndërkombëtarë e kanë marrë në konsideratë si faktor lehtësues ekzistencën e masave mbrojtëse gjatë marrjes së vendimit në lidhje me lirim të përkohshëm,⁶⁵ në të tjera raste ekzistenca e masave mbrojtëse është konsideruar po aq si faktor që rrit shqetësimet e dhomës në lidhje me miratimin e lirimit të përkohshëm.⁶⁶

34. Gjithsesi, edhe pse arsyetimi në Vendimin e Kontestuar mund të kishte qenë më i hollësishëm, Paneli është bindur se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka marrë në konsideratë shkallën e masave mbrojtëse në këtë çështje gjyqësore dhe ka bërë një vlerësim nëse këto masa do t'i kishin zvogëluar mjaftueshëm rreziqet e identifikuar.⁶⁷

⁶² Shih më lart, para. 30.

⁶³ Shih më lart, para. 28.

⁶⁴ *Contra* Apeli, para. 27; Kundërpërgjigjja, para. 9.

⁶⁵ Shih edhe F00005, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (“Vendimi mbi Apelin e Veselit”), para. 51 dhe jurisprudenca e cituar në të.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Vendimi i Kontestuar, para. 39.

Paneli pajtohet se janë miratuar masa mbrojtëse për një numër të konsiderueshëm dëshmitarësh në këtë çështje gjyqësore dhe vëren se, për disa syresh, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka urdhëruar [REDAKTUAR];⁶⁸ (ii) [REDAKTUAR];⁶⁹ ose (iii) [REDAKTUAR].⁷⁰ Në kohën e lëshimit të Vendimit të Kontestuar,⁷¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake, duke rikujtuar se [REDAKTUAR], konstatoi se, [REDAKTUAR].⁷² Paneli pajtohet me këtë vlerësim dhe konstaton se vijon të jetë i vlefshëm [REDAKTUAR].⁷³ Paneli nuk konstaton se [REDAKTUAR] cenon këtë konstatim të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

⁶⁸ Shih F00133/COR/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Versionit të Korrigjuar të Vendimit të Parë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse, 14 dhjetor 2020 (konfidencial) (origjinali u protokollua më 10 dhjetor 2020) ("Vendimi i Parë mbi Masat Mbrojtëse"), para. 132(d); F00190/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit mbi Kërkesën e Dytë të Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesën e Përsëritur për Masa Mbrojtëse dhe Çështje Procedurale, 5 shkurt 2021 (konfidencial) (origjinali u protokollua më 5 shkurt 2021) ("Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse"), para. 144(d). Shih edhe vendimet e mëposhme të marra pas Vendimit të Kontestuar: F00373/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Gjashtë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse, 25 qershor 2021 (konfidencial) (origjinali u protokollua më 25 qershor 2021) ("Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse"), para. 107(b); F00407/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Shtatë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse, 21 korrik 2021 (konfidencial) (origjinali u protokollua më 21 korrik 2021) ("Vendimi i Shtatë mbi Masat Mbrojtëse"), para. 148(b); F00438/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Tetë mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse, 24 gusht 2021 (konfidencial) (origjinali u protokollua më 24 gusht 2021) ("Vendimi i Tetë mbi Masat Mbrojtëse"), para. 93(f).

⁶⁹ Shih Vendimi i Parë mbi Masat Mbrojtëse, para. 132(h); Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse, para. 144(e); F00338/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit të Pestë në lidhje me Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse, 7 qershor 2021 (konfidencial) (origjinali u protokollua më 4 qershor 2021) ("Vendimi i Pestë mbi Masat Mbrojtëse"), para. 76(c); Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse, para. 107(c); Vendimi i Shtatë mbi Masat Mbrojtëse, para. 148(c); Vendimi i Tetë mbi Masat Mbrojtëse, para. 93(g).

⁷⁰ Shih Vendimi i Parë mbi Masat Mbrojtëse, para. 132(k); Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse, para. 144(g); Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse, para. 76(b); Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse, para. 107(d); Vendimi i Shtatë mbi Masat Mbrojtëse, para. 148(d); Vendimi i Tetë mbi Masat Mbrojtëse, para. 93(h).

⁷¹ Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse është marrë më të njëjtë ditë me Vendimin e Kontestuar.

⁷² Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse, para. 90. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatonte gjithashtu se [REDAKTUAR]. Shih Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse, para. 91. Në Vendimin e Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake [REDAKTUAR]. Shih Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse, para. 107(c) dhe (d).

⁷³ Shih Vendimi i Shtatë mbi Masat Mbrojtëse, para. 148(d) [REDAKTUAR]; Vendimi i Tetë mbi Masat Mbrojtëse, para. 93(h) [REDAKTUAR]. Shih edhe Vendimi i Tetë mbi Masat Mbrojtëse, para. 64, 66.

35. [REDAKTUAR].⁷⁴ Paneli vëren se Krasniqi nuk përmend se [REDAKTUAR].⁷⁵ [REDAKTUAR].⁷⁶ Në bazë të konstatimeve, të lëna në fuqi në Apel, sa i takon predispozitës personale të Krasniqit për frikësim të dëshmitarëve dhe [REDAKTUAR],⁷⁷ Paneli nuk konstaton asnjë gabim në përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se masat mbrojtëse në fuqi nuk mjaftojnë për ta zvogëluar rrezikun “vetvetiu të lartë” të frikësimit ose ndërhyrjes të dëshmitarët.⁷⁸ Për rrjedhojë, Paneli mendon se Krasniqi nuk ka identifikuar asnjë gabim të dallueshëm apo shpërdorim të diskrecionit në marrjen në konsideratë të masave mbrojtëse nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

36. Në bazë të sa më lart, Paneli i Gjykatës së Apelit i rrëzon argumentet e Krasniqit në lidhje me pretendimin për vlerësim të gabuar të nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit.

2. Neni 41(6)(b)(iii) i Ligjit

37. Duke pasur parasysh se Paneli nuk ka konstatuar asnjë gabim në përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ekzistonte rreziku i pengimit të procedurave sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, çka e bën mbajtjen në paraburgim të domosdoshme, nuk është e nevojshme të trajtohen pretendimet e Krasniqit në lidhje me faktorët mbi të cilët u mbështet Gjykatësi i Procedurës Paraprake në bërjen e konstatimit për ekzistencën e rrezikut sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit.⁷⁹ Paneli i Gjykatës së Apelit rikujton se kushtet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit janë alternativa të njëri-

⁷⁴ Shih Vendimi i Parë mbi Masat Mbrojtëse, para. 38, 43, 56, 63, 84, 95, 104; Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse, para. 48, 58, 70; Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse, para. 22, 34, 41, 48, 56; Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse, para. 25, 36, 47, 57, 66, 76, 88; Vendimi i Shtatë mbi Masat Mbrojtëse, para. 49, 72, 89, 99, 109, 118; Vendimi i Tetë mbi Masat Mbrojtëse, para. 39-40, 51, 61.

⁷⁵ Shih Vendimi i Parë mbi Masat Mbrojtëse, para. 124-125, 132(q); Vendimi i Dytë mbi Masat Mbrojtëse, para. 135-136, 144(k); Vendimi i Gjashtë mbi Masat Mbrojtëse, para. 74-75, 76(g); Vendimi i Shtatë mbi Masat Mbrojtëse, para. 143, 145, 148(i); Vendimi i Tetë mbi Masat Mbrojtëse, para. 88-89, 93(m).

⁷⁶ *Contra* Apeli, para. 29-30.

⁷⁷ Shih më lart, para. 30. Shih edhe Vendimi i Kontestuar, para. 35, 38.

⁷⁸ Shih Vendimi i Kontestuar, para. 39.

⁷⁹ Shih Apeli, para. 33-39.

tjetrit.⁸⁰ Nëse përmbushet njëri prej kushteve, nuk është e nevojshme të trajtohen kushtet e tjera për mbajtjen në paraburgim. Për rrjedhojë, nuk është nevoja të trajtohen gabimet të cilat Krasniqi i pretendon në lidhje me nenin 41(6)(b)(iii) të Ligjit.⁸¹ Rrjedhimisht, çdo konstatim i Panelit në lidhje me argumentet e Krasniqit nuk do të ndikonte në rezultatin e Vendimit të Kontestuar. Gjithsesi, Panelit i duhet të trajtojë nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar kur konstatoi se rreziku i pengimit të procedurës nuk mund të zvogëlohet me kushtet e propozuara. Panelit i duhet të trajtojë edhe argumentet e Palëve lidhur me proporcionalitetin e paraburgimit.

D. GABIMET E PRETENDUARA LIDHUR ME VLERËSIMIN E PROPORCIONALITETIT TË PARABURGIMIT (ARSYEJA 4)

1. Parashtrimet e Palëve

38. Krasniqi argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë gabime të dallueshme kur arriti në përfundimin se vazhdimi i mbajtjes së tij në paraburgim është proporcional.⁸² Ai parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar kur konstatoi se data e fillimit të gjykimit është ende e paqartë dhe nuk mori në konsideratë proporcionalitetin në raport me faktin se data më e hershme e mundshme për fillimin e tij është mesi i janarit 2022.⁸³ Sipas Krasniqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi edhe kur e shqyrtoi moslejimin e vizitave familjare veçmas nga vlerësimi i proporcionalitetit dhe kur konstatoi se ky moslejim ishte proporcional me qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit të tij dhe të tjerëve në një situatë të jashtëzakonshme të shëndetit publik.⁸⁴ Së fundi, Krasniqi parashtron se mbajtja i

⁸⁰ Shih, p.sh., KSC-BC-2020-04, F00005/RED, Vendim i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit në lidhje me Lirimën e Përkohshëm, 20 gusht 2021 (origjinali u protokollua më 20 gusht 2021) ("Vendimi mbi Apelin e Shalës"), para. 43; Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 66; Vendimi mbi Apelin e Thaçit, para. 78.

⁸¹ Shih Apeli, para. 33-39.

⁸² Apeli, para. 47-53, ku i referohet Vendimit të Kontestuar, para. 58-60.

⁸³ Apeli, para. 47-49.

⁸⁴ Apeli, para. 48, 50-51; Kundërpërgjigja, para. 14.

ndaluar në Holandë do të vijojë t'ia kufizojë atij mundësinë të ketë takime nga afër, edhe kur këto takime të rifillojnë në mes të korrikut 2021.⁸⁵

39. ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka gabuar në arritjen e përfundimit se vlerësimi i kohëzgjatjes së paraburgimit ishte i parakohshëm dhe i hamendshëm, duke pasur parasysh dallimet në vlerësimet e bëra nga Palët dhe se Paneli i Gjykatës së Apelit ka konstatuar se një vlerësim i tillë nuk është i nevojshëm.⁸⁶ ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka marrë në konsideratë çështjen e vizitave familjare dhe se Krasniqi thjesht sa nuk pajtohet me peshën që i ka dhënë këtij faktori.⁸⁷

40. Krasniqi kundërpërgjigjet se Përgjigjja nuk merr parasysh menaxhimin e ndryshëm të vizitave familjare në burgjet holandeze dhe se kufizimi i disa të drejtave në burgjet kosovare nuk mund të barazohet me një ndalim tetëmuor të vizitave familjare.⁸⁸

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

41. Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujtoi saktë rëndësinë e parimit të proporcionalitetit në marrjen e vendimit lidhur me arsyeshmërinë e paraburgimit.⁸⁹ Koha e kaluar në paraburgim në pritje të fillimit të gjyqit është një faktor që duhet mbajtur në konsideratë krahas rreziqeve të përshkruara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, për të vendosur nëse, pasi marrjes në konsideratë të të gjithë faktorëve, mbajtja në paraburgim “pushon së qeni e arsyeshme” dhe individi duhet të lirohet.⁹⁰ Paneli rikujton më tej konstatimin e vet në Vendimin mbi Apelin e Krasniqit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte gabuar në ndjekjen e një qasjeje të ndryshme nga disa gjykatës të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë,

⁸⁵ Apeli, para. 52; Kundërpërgjigjja, para. 14, poshtëshërimi 27.

⁸⁶ Përgjigjja, para. 27-28.

⁸⁷ Përgjigjja, para. 28.

⁸⁸ Kundërpërgjigjja, para. 15.

⁸⁹ Vendimi i Kontestuar, para. 58. Shih edhe Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 69.

⁹⁰ Vendimi i Kontestuar, para. 58.

të cilët morën në konsideratë kohëzgjatjen e mundshme të paraburgimit në ushtrimin e diskrecionit të tyre për të liruar të akuzuarin, sidomos në kuadër të rishikimit periodik të domosdoshmërisë së vazhdimit të mbajtjes në paraburgim.⁹¹

42. Paneli vëren gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka mbajtur në konsideratë faktorët e mëposhtëm kur arriti në përfundimin se mbajtja në paraburgim e Krasniqit deri më tani është proporcionale dhe se diskutimi mbi kohëzgjatjen e pritshme të paraburgimit ishte veç i hamendshëm në atë moment: (i) kundër Krasniqit janë ngritur dhjetë akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në lidhje me ngjarje në disa vendndodhje për një periudhë të gjatë kohore; (ii) nëse shpallet fajtor, mund t'i jepet dënim i gjatë; (iii) kompleksiteti i çështjes gjyqësore; (iv) rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me asnjë kusht shtesë; (v) do të përfundohen të gjithë hapat proceduralë të fazës paraprake për t'ia kaluar dosjen trupit gjykues në të ardhmen e parashikueshme; dhe (vi) afatet kohore janë respektuar, ose janë shtyrë për arsye të vlefshme, përfshirë edhe me kërkesë të Krasniqit.⁹² Gjykatësi i Procedurës Paraprake theksoi edhe ekzistencën e rishikimit periodik të paraburgimit.⁹³

43. Megjithëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i ka përmendur shprehimisht vlerësimet e Palëve sa i takon datës së mundshme të fillimit të gjykimit si një prej faktorëve që ka marrë në konsideratë lidhur me proporcionalitetin, ai e ka mbajtur shënim argumentin e Mbrojtjes se Palët kishin mendime shumë të ndryshme sa i takon datës së mundshme të fillimit të gjykimit.⁹⁴ Duke pasur parasysh fazën në të cilën ndodhet tani procedura paraprake dhe qëndrimet gjithnjë të ndryshme të Palëve sa i takon datës së mundshme të fillimit të gjykimit, dhe për rrjedhojë edhe sa i takon kohëzgjatjes së mundshme të periudhës paraprake, Paneli konstaton se sërish nuk

⁹¹ Vendimi mbi Apelin e Krasniqit, para. 71 dhe jurisprudenca e cituar në të. Shih edhe rregulla 57(2) e Rregullores; neni 41(10) i Ligjit.

⁹² Vendimi i Kontestuar, para. 59.

⁹³ Vendimi i Kontestuar, para. 59.

⁹⁴ Vendimi i Kontestuar, para. 55, ku citohen Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 35-39.

ishte e paarsyeshme dhe se ishte në diskrecionin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të konstatonte, si edhe në vlerësimin e tij të mëparshëm, se çdo përcaktim *në fazën e tanishme* sa i takon kohëzgjatjes së pritshme totale të mbajtjes së Krasniqit në paraburgim është krejt i hamendshëm.⁹⁵

44. Për të trajtuar tani argumentet e Krasniqit lidhur me çështjen e vizitave familjare, Paneli është i mendimit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e mori posaçërisht këtë çështje në konsideratë në marrjen e vendimit nëse mbajtja në paraburgim vazhdon të jetë e arsyeshme. Kjo duket qartë jo vetëm nga shqyrtimi i këtij aspekti nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në pjesën me titull “Proporcionaliteti i paraburgimit”,⁹⁶ por edhe nga mbajtja në vëmendje nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake e mundësisë së *ardhshme* të vizitave familjare në kuadër të vlerësimit nëse *vijimi* i mbajtjes në paraburgim të Krasniqit është proporcional. Megjithëse diskutimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake për kufizimet mbi të drejtën për jetë familjare të Krasniqit është vërtet i shkurtër dhe nuk trajton me hollësi jurisprudencën ose argumentet faktike të paraqitura në parashtrimet e Krasniqit,⁹⁷ Paneli nuk është bindur se qasja me shikim nga ardhmja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake është e paarsyeshme, duke pasur parasysh informacionin e dhënë nga Administratorja e Dhomave të Specializuara, pra që vizitat familjare do të rifillonin më 15 korrik 2021, më pak se tri javë pas marrjes së Vendimit të Kontestuar.⁹⁸

45. Gjithashtu, sa i takon gabimit të pretenduar se nuk është shqyrtuar vështirësia e Krasniqit për të pasur takime personale me anëtarët e familjes edhe pas heqjes së

⁹⁵ *Contra* Apeli, para. 49.

⁹⁶ Vendimi i Kontestuar, para. 55, 57, 59-60.

⁹⁷ Vendimi i Kontestuar, para. 60; Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 40-44; Kundërpërgjigjja mbi Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 12-13.

⁹⁸ Vendimi i Kontestuar, para. 60, ku citohet F00353/RED, Version i Redaktuar Publik i “Përditësimi të Parashtrimeve të Administratores në pajtim me rregullën 23(2) mbi Masat për Zbutjen e Rrezikut të KOVID-19, parashtrim i protokolluar F00353 i datës 16 qershor 2021, 17 qershor 2021 (origjinali u protokollua më 16 qershor 2021) (“Përditësimi i Administratores mbi Masat kundër KOVID-19”), para. 15, 17. Shih edhe F00402, Parashtrimet e Administratores për Konferencën e Gjashtë për Ecurinë e Çështjes, 16 korrik 2021, para. 8.

kufizimeve, për shkak se mbahet në paraburgim në Holandë, Paneli vëren se ky argument nuk është ngritur para Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe ngrihet, pra, për herë të parë në Apel.⁹⁹ Administratorja e informoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake dhe Palët lidhur me rifillimin e ardhshëm të vizitave familjare me parashtrimin e protokolluar të datës 16 qershor 2021, dy ditë përpara se Krasniqi t'i dorëzonte parashtrimet kundërpërgjigjëse Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁰⁰ Duke qenë se Krasniqi mund ta kishte ngritur në mënyrë të arsyeshme këtë argument para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Paneli e rrëzon pa e marrë në shqyrtim.¹⁰¹

46. Për rrjedhojë, rrëzohet arsyeja e apelit të Krasniqit në lidhje me vlerësimin e proporcionalitetit të paraburgimit të tij.

E. GABIMET E PRETENDUARA LIDHUR ME VLERËSIMIN E KUSHTEVE TË LIRIMIT (ARSYEJA 3)

1. Parashtrimet e Palëve

47. Krasniqi parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë gabime të dallueshme në nxjerrjen e përfundimit se lirimi i përkohshëm me kushte do t'i zvogëlonte në mënyrë të pamjaftueshme rreziqet e identifikuar saktë.¹⁰² Ai argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka konsideruar siç duhet kushtet e mundshme të lirimit dhe ka shpërfillur ose nuk ka dhënë arsye për rrëzimin e parashtrimeve lidhur me këtë.¹⁰³ Konkretisht, Krasniqi argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka parë tërësinë e provave që tregojnë se Policia Kosovare

⁹⁹ Apeli, para. 52.

¹⁰⁰ Shih Përditësimi i Administratores mbi Masat kundër COVID-19, protokolluar më 16 qershor 2021; Kundërpërgjigjja mbi Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, protokolluar më 18 qershor 2021.

¹⁰¹ Vendimi mbi Apelin e Haradinajt, para. 29, 38; Vendimi mbi Apelin e Veselit, para. 51. Shih edhe Vendim mbi Apelet e Gucatit dhe Haradinajt mbi Mocionet Paraprake, para. 15; Vendimi mbi Apelin e Shalës, para. 8.

¹⁰² Apeli, para. 4(3), 40-46, ku i referohet Vendimit të Kontestuar, para. 50-52.

¹⁰³ Apeli, para. 41-42; Kundërpërgjigjja, para. 11, ku citohet, ndër të tjera, Vendimi i Kontestuar, para. 50-52; Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 48-51; F00358/A01, Shtojca 1 e Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes mbi Rishikimin e Paraburgimit, 18 qershor 2021 (konfidencial) ("Shtojca e Kundërpërgjigjes së Krasniqit mbi Rishikimin e Paraburgimit").

do të ishte në gjendje t'i monitoronte komunikimet e tij private.¹⁰⁴ Krahas kësaj, ai parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka rrëzuar në mënyrë të paarsyetuar deklaratën e Policisë së Kosovës si një pohim të përgjithshëm pa bërë hetime *proprio motu*, duke pasur parasysh se ajo lidhej shprehimisht me kërkesën e Mbrojtjes që bënte pyetje posaçërisht lidhur me aftësinë e saj për të monitoruar komunikime.¹⁰⁵

48. Gjithashtu, Krasniqi kundërshton vëmendjen që i kushton Gjykatësi i Procedurës Paraprake mundësisë së tij për të përdorur pajisje elektronike të dikujt tjetër ose për të kaluar informacion përmes dikujt tjetër, çka ndryshon nga konstatimet e mëparshme që përqendroheshin te aftësia e Policisë së Kosovës për të monitoruar dhe siguruar zbatimin të kushteve.¹⁰⁶ Sipas Krasniqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka konsideruar se si mund të zvogëloheshin këto rreziqe me anë të kushteve shtesë dhe nuk ka shpjeguar përse ato nuk mjaftojnë për ta zvogëluar rrezikun në nivel të pranueshëm.¹⁰⁷

49. ZPS-ja përgjigjet se Krasniqi thjesht nuk pajtohet me shpjegimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me arsyen përse asnjë kusht nuk mund t'i zvogëlojë rreziqet, por nuk identifikon asnjë gabim në të.¹⁰⁸ Sipas ZPS-së, nëse asnjë kusht nuk mund t'i zvogëlojë rreziqet e identifikuar, Dhoma "nuk është e detyruar të vlerësojë gatishmërinë dhe aftësinë e një shteti për t'i zbatuar kushtet".¹⁰⁹ Në çdo rast, ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ka peshuar siç duhet garancitë e Policisë së Kosovës.¹¹⁰ ZPS-ja mbështetet më tej në një vendim të mëparshëm në të cilin Paneli i Gjykatës së Apelit e la në fuqi konstatimin e Gjykatësit të Procedurës

¹⁰⁴ Apeli, para. 42.

¹⁰⁵ Apeli, para. 43.

¹⁰⁶ Apeli, para. 44; Kundërpërgjigjja, para. 13, ku citohet Vendimi i Kontestuar, para. 52; Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 49.

¹⁰⁷ Apeli, para. 45.

¹⁰⁸ Përgjigjja, para. 25.

¹⁰⁹ Përgjigjja, para. 26.

¹¹⁰ Po aty.

Paraprake sipas të cilit garancitë e vagullta të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës ishin të pamjaftueshme.¹¹¹

50. Krasniqi kundërpërgjigjet se konstatimi i mëparshëm i Panelit të Gjykatës së Apelit lidhur me pamjaftueshmërinë e një garancie nuk është relevant – garancitë e reja u përgjigjeshin pyetjeve konkrete të Mbrojtjes dhe përputheshin me materiale të tjera, të cilat Vendimi i Kontestuar nuk i mori në vlerësim.¹¹² Së fundi, Krasniqi argumenton se në kundërshtim me parimin se paraburgimi përbën përjashtim në Dhomat e Specializuara, Vendimi i Kontestuar përdori një standard tejet të lartë, duke u përqendruar te mundësia e kalimit të informacionit përmes të tjerëve, pavarësisht nga provat për zbatueshmërinë e kufizimeve mbi kontaktet e tij, monitorimin e komunikimeve dhe ekzistencën e masave mbrojtëse.¹¹³

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

51. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujtoi konstatimin e tij të mëparshëm se vetëm përmes kuadrit monitorues të komunikimeve që ka Objekti i Paraburgimit të Dhomave të Specializuara mund të kufizohen dhe të monitorohen në mënyrë të efektshme komunikimet e Krasniqit, për të zvogëluar kështu rrezikun e pengimit të procedurave apo dhënies së kontributit në krime.¹¹⁴ Gjithashtu, ai konstatoi se, as kushtet e propozuara nga Krasniqi, as edhe ndonjë kufizim tjetër i mëtejshëm, nuk do ta zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun e pengimit të procedurave apo rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera.¹¹⁵ Ai konstatoi edhe se garancitë shitesë të propozuara nga Krasniqi i trajtojnë në mënyrë të pamjaftueshme rreziqet, duke konstatuar në veçanti se, pavarësisht nga pyetjet e hollësishme që Mbrojtja i bëri Policisë së Kosovës, deklarata e kësaj të fundit përbente një pohim të përgjithshëm që nuk shpjegonte nëse

¹¹¹ Po aty.

¹¹² Kundërpërgjigjja, para. 12.

¹¹³ Kundërpërgjigjja, para. 13, ku citohet Vendimi i Kontestuar, para. 52; Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 49.

¹¹⁴ Vendimi i Kontestuar, para. 50.

¹¹⁵ Vendimi i Kontestuar, para. 53.

kushtet e propozuara nga Krasniqi apo ndonjë masë tjetër e vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në veçanti për të parandaluar komunikimet e ndaluara, mund të zbatoheshin në mënyrë të efektshme dhe, nëse po, cilat masa do të zbatoheshin.¹¹⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se, edhe masa të tjera, si kufizimi i përdorimit të internetit dhe telefonit (celular), instalimi i një programi për regjistrimin e tasteve të shtypura apo i pajisjeve të ngjashme monitoruese, nuk do të parandalonin përdorimin nga Krasniqi të pajisjeve elektronike që u përkasin personave të tjerë, si anëtarë të familjes apo të njohur të tij, apo që ai t'u japë udhëzime personave të tjerë me qëllim frikësimin dhe/ose ndërhyrjen tek dëshmitarë, duke pasur parasysh pozitën e tij me ndikim dhe [REDAKTUAR].¹¹⁷

52. Paneli i Gjykatës së Apelit do të trajtojë fillimisht argumentin e Krasniqit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar në ngritjen e shqetësimeve lidhur me mundësinë e kalimit të informacioneve përmes të tjerëve. Së pari, Paneli nuk është bindur se ishte e paarsyeshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake e mori në shqyrtim këtë formë komunikimi të tërthortë për herë të parë në këtë vendim, pa e përmendur në vendimet e mëparshme lidhur me paraburgimin e Krasniqit.

53. Së dyti, Paneli gjithashtu nuk është bindur se kjo marrje në konsideratë vendos një standard tejet të lartë për lirimin e përkohshëm në rastin e Krasniqit. Kushtet e lirimimit “duhet të përshtaten në mënyrë proporcionale për të zvogëluar rreziqet e identifikuar”.¹¹⁸ Për pasojë, Krasniqi nuk ka arritur të tregojë se marrja në konsideratë e rrugëve të komunikimit të tërthortë ishte e paarsyeshme përballë rreziqeve të rënda të identifikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nëse Krasniqi do të ishte në gjendje të komunikonte në mënyrë të paautorizuar, si dhe të pasojave të rënda që mund të rridhnin nga komunikime të tilla. Rrjedhimisht, Paneli i rrëzon argumentet e

¹¹⁶ Vendimi i Kontestuar, para. 51.

¹¹⁷ Vendimi i Kontestuar, para. 52.

¹¹⁸ ICC, *Prosecutor v. Gbagbo and Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-1251-Red2, Second Public Redacted Judgment on the Prosecutor's appeal against the oral decision of Trial Chamber I pursuant to article 81(3)(c)(i) of the Statute, 21 shkurt 2019, para. 54.

Krasniqit lidhur me marrjen në konsideratë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të mjeteve të tërthorta të komunikimit në kuadër të arsytimit të tij.

54. Paneli vëren se Krasniqi ka propozuar vërtet një listë të hollësishme kushtesh të cilat, teorikisht, mund t'i kufizonin dhe monitoronin komunikimet e tij. Pavarësisht nga kjo, Paneli thekson se lipset gjithsesi të vlerësohet nëse këto masa mund të zbatohen në mënyrë të efektshme. Në këtë aspekt, Paneli konstaton se gatishmëria dhe aftësia e Policisë së Kosovës për të siguruar zbatimin e kushteve të propozuara mund të ndihmonin në zvogëlimin e rreziqeve të identifikuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Rrjedhimisht, paneli kompetent duhet të shqyrtojë, sipas rastit, nëse garancitë e dhëna mund t'i zvogëlojnë siç duhet rreziqet. Një shqyrtim i tillë duhet bërë rast pas rasti. Paneli mendon se, duke pasur parasysh listën e gjatë të kushteve të propozuara nga Krasniqi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mund të arrinte në përfundimin se asnjë prej këtyre kushteve nuk i zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e identifikuara pa kërkuar informacion të mëtejshëm mbi zbatueshmërinë e këtyre masave.

55. Duke iu kthyer rrjedhimisht garancive të dhëna nga Policia e Kosovës, Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se përgjigja e ardhur nga [REDAKTUAR] ("Drejtori i Policisë"), duke pasur parasysh natyrën e saj të përgjithshme dhe përgjithësuese, nuk mund të konsiderohet se përbën një përgjigje pozitive ndaj pyetjeve të hollësishme të bëra nga Mbrojtja, në kundërshtim me parashtrimin e Krasniqit.¹¹⁹ Po kështu, Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se, duke pasur parasysh nivelin e hollësive të pyetjeve të bëra nga Mbrojtësi i Krasniqit,¹²⁰ nga Drejtori i Policisë pritej një përgjigje më konkrete, e mbështetur me dokumentacion përkatës si edhe me masa konkrete që mund të zbatoheshin, e cila nuk

¹¹⁹ Shtojca e Kundërpërgjigjes së Krasniqit mbi Rishikimin e Paraburgimit, p. 2; Vendimi i Kontestuar, para. 51. Shih *contra* Apeli, para. 43.

¹²⁰ Shtojca e Kundërpërgjigjes së Krasniqit mbi Rishikimin e Paraburgimit, f. 3-4.

është dhënë.¹²¹ Në këto kushte, Paneli konstaton se, megjithëse garancitë e Policisë së Kosovës duket se demonstrojnë gatishmërinë e saj për të garantuar zbatimin e kushteve të propozuara, nisur nga informacioni i paktë në dispozicion, nuk është e mundshme të vlerësohen kapaciteti dhe burimet faktike të Policisë së Kosovës për t'i vënë në zbatim këto masa.

56. Megjithatë, Paneli konstaton se, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të konsideronte, sikurse në fakt konsideroi, se përgjigja e ardhur nga Policia e Kosovës nuk ishte bindëse mjaftueshëm, ai duhet t'i ishte drejtuar Drejtorit të Policisë për të marrë përgjigjen e hollësishme që sipas konstatimit të tij mungonte, sidomos pasi që Krasniqi ia kërkoi shprehimisht ta bënte një gjë të tillë¹²² dhe përgjigja e Drejtorit të Policisë lë të kuptohet aftësinë e Policisë së Kosovës për të garantuar zbatimin e kushteve.¹²³ Paneli rikujton se kërkimi i këtij informacioni përfshihet në kompetencat diskrecionale të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të cilat ia jep neni 39(13) i Ligjit lidhur me çështje që kanë të bëjnë me paraburgimin, në varësi të rrethanave të rastit.¹²⁴ Paneli vëren edhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka dhënë arsye pse nuk i dha urdhër Drejtorit të Policisë të jepte përgjigje të hollësishme, pavarësisht se pranoi nevojën për një përgjigje të tillë.

57. Rrjedhimisht, nisur nga rrethanat konkrete të rastit, Paneli e gjen me vend parashtrimin e Krasniqit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka shpërdoruar kompetencën e tij diskrecionale në nxjerrjen e përfundimit se asnjë prej kushteve të

¹²¹ Vendimi i Kontestuar, para. 51.

¹²² Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 51. Paneli vëren se kërkesa që Krasniqi i paraqiti Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të kërkuar informacion nga Policia e Kosovës ishte bërë përpara dorëzimit nga Krasniqi të garancive të dhëna nga Policia e Kosovës në përgjigje të pyetjeve të tij, dhe se Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i është paraqitur ndonjë kërkesë tjetër pas dorëzimit të këtyre garancive. Por Paneli mendon se gjithsesi, në këto rrethana, kërkesa e parë duhet ta kishte shtyrë Gjykatësin e Procedurës Paraprake të mendonte nëse duhej të kërkonte informacion të mëtejshëm, kur, pasi i shqyrtoi garancitë e Policisë Kosovare të paraqitura nga Krasniqi, konstatoi se ato nuk ishin të hollësishme sa duhet.

¹²³ Shtojca e Kundërpërgjigjes së Krasniqit mbi Rishikimin e Paraburgimit, f. 2: [REDAKTUAR] (theksimi i shtuar).

¹²⁴ Vendimi mbi Apelin e Shalës, para. 60.

propozuara nga Krasniqi dhe asnjë kusht shtesë nuk mund t'i zvogëlonte rreziqet e identifikuar, pa kërkuar fillimisht parashtrime shtesë nga Drejtori i Policisë. Paneli konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar që nuk e bëri këtë, duke qenë se ky informacion do t'i kishte dhënë mundësi të vlerësonte nëse Policia e Kosovës mund t'i zbatojë apo jo këto masa në mënyrë efektive. Një informacion më preciz i këtij lloji do t'i jepte Gjykatësit të Procedurës Paraprake një bazë faktike më të plotë dhe solide për të vlerësuar realizueshmërinë e kushteve të tilla, sigurisht pa paragjykuar rezultatin e vendimit përfundimtar mbi këto aspekte.

58. Sa më lart, Paneli i Gjykatës së Apelit e pranon arsyen 3 të apelit dhe ia kthen çështjen Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të vlerësuar nëse Policia e Kosovës është në gjendje të zbatojë në mënyrë të efektshme kushtet e propozuara nga Krasniqi apo çdo kusht shtesë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake e identifikon si të nevojshëm për të zvogëluar rreziqet e identifikuar.

59. Nisur nga ky konstatim, nuk është e nevojshme që Paneli të trajtojë argumentin tjetër të Krasniqit lidhur me mosmarrjen parasysh nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të garancive të Policisë së Kosovës në bazë të kuadrit ligjor të zbatueshëm lidhur me monitorimin e komunikimeve dhe materialet nga burime të hapura për përdorimin e këtyre kompetencave në praktikë nga Policia e Kosovës.¹²⁵

IV. VENDIM

60. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON arsyen 3 të Apelit të Krasniqit;

KTHEN çështjen te Gjykatësi i Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm në përputhje me paragrafët 56-58 të këtij Vendimi;

¹²⁵ Apeli, para. 42; Kundërpërgjigja, para. 12.

RRËZON të gjitha aspektet e tjera të Apelit (arsyet 1, 2 dhe 4 të Apelit të Krasniqit); dhe

URDHËRON Krasniqin të dorëzojë për protokollim versione të redaktuara publike të Apelit dhe Kundërpërgjigjes së tij, ose të bëjë të ditur, me anë të një parashtrimi, nëse këto parashtrime mund të riklasifikohen si publike brenda dhjetë ditësh pas marrjes njoftim të këtij Vendimi.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

E premte, 1 tetor 2021

Hagë, Holandë